

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

AMH - Albanian Management Hospitality SH.P.K.

Sot, më datë 02.05.2024

Ferdinand SHEHU, lindur ne Tirane, i datëlindjes 10.07.1963, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi Karte identiteti G30710252C

Blendi RESULI, lindur ne Durres, i datëlindjes 17.10.1989, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi Karte identiteti I91017007B

Florian BILALI, lindur ne Durres, i datëlindjes 24.09.1972, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi Karte identiteti H20924056J

Kane përpiluar këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **AMH - Albanian Management Hospitality SH.P.K.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare **AMH - Albanian Management Hospitality SH.P.K.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë


Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **AMH - Albanian Management Hospitality SH.P.K.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

Aktivitet në fushën e turizmit. Veprimtari ne fushen e strukturave akomoduese hoteleri, beach bar, privat me plan sherbimi te personalizuar dhe plan sherbimi "çdo gje e perfshire"(all inclusive),



shezllone, stacione plazhi, pishine, lundrime turistike, sporte ujore, piste ne det me lokacion bar restorant, bendbazim per mjete ujore, motorike dhe jo motorike, etj.

Kryerje e shërbimeve të agjensive për veprimtari turistike brenda dhe jashtë vendit. Organizimin e aktiviteteve muzikore, kulturore, sportive e argëtuese Organizim i tureve guidave te ndryshme turistike.

Aktivitet ne fushen e shërbimeve të Bar- Kafe, Resorant, Piceri, Pastiçeri. Shërbim shpërndarje (Delivery) për bar dhe restorant.

Investime në fushën e hotelerisë dhe turizmit, hapjen e bareve dhe restoranteve brenda këtyre strukturave, hapjen, administrimin dhe/ose menaxhimin e lojrave të fatit dhe kazinove brenda hoteleve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Hapja dhe menaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier. Hapja, administrimi dhe / ose menaxhimi i funksionimit të qendrave të rekreacionit, me ose pa profil të dermo-estetikës, trajtimit të lëkurës dhe trupit , për masazhe, spa, mirëmbajtje trupore, fitness, dhe pishina.

Menaxhim dhe administrim i pasurive të paluajtshme, kryesisht me veprimtari në Hoteleri – Turizëm.

Studime per te tretet ne fushen e turizmit dhe te menaxhimit te turizmit.

Aktivitet në fushën imobiliare e te qiradhënies së zyrave, ambjenteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme . Import – Eksport të mallrave e artikujve të ndryshëm industrialë dhe ushqimore, të pajisjeve te ndryshme aksesore hotelerie etj.

Shoqëria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqërisë, e cila nuk ndalohe me ligj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqëria ka seline ligjore:

Durres, Lagjja 13, Rruga Pavaresia, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Godine me nr. Pasurie Nr.395/Nd. Shoqëria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithë territorin shqiptar dhe jashte tij.



NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqindmije) lekë dhe përbëhet nga 3(tre) kuota.

Ferdinand SHEHU, është zotërues i 1 kuote, me 33 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 33.000 leke.

Blendi RESULI, është zotërues i 1 kuote, me 34 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 34.000 leke.

Florian BILALI, është zotërues i 1 kuote, me 33 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 33.000 leke.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë.

Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjeçar,

me te drejte riemerimi. Administrator i Shoqërisë do të jetë: **Z. Blendi RESULI**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, entë publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisllacionin në fuqi.





NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqërisë. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

ORTAKET THEMELUES

Ferdinand SHEHU

Blendi RESULI


Florian BILALI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER FLORIAN F. HOXHA



V2024011710031359287

DATE 02/05/2024
NR REP 654



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 02/05/ 2024 (Dymije e njezet e kater), para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durrës, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUET/IT: Ferdinand Shehu, atësia Shyqri, amësia Xhemalle, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Lidhja E Prizrenit; Nd. 5; H. 1; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 10/07/1963, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035976420 dhe nr. personal G30710252C.

NËNSHKRUET/IT: Blendi Resuli, atësia Resul, amësia Hazbije, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë Kristaq Rama 00690433; Nd. 2; H. 1; Ap. 1; Durrës; Durrës; 2008; Durrës, lindur më 17/10/1989, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036583641 dhe nr. personal I91017007B.

NËNSHKRUET/IT: Florian Bilali, atësia Reshat, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Lagja Nr 7rr Hajdar Demiri; Durrës; 0000; Durrës, lindur më 24/09/1972, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034830764 dhe nr. personal H20924056J.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, "Akt Themelimi te Shoqerise", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
FLORIAN F. HOXHA